



PROCESVERBAL NGA Mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 44

Datë: 16. 12. 2022. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Shqyrtimi dhe miratim i procesverbaleve të mbledhjes Nr. 38, 39 dhe 40/2022**
- 3. Aktivitetet e SKQZ-së**
- 4. Raport nga Zyra**

Rekomandim për çregjistrimin e Partisë Politike Ujedinjena Stranka Bošnjaka-USB

- 5. Raportet e Këshillave të KQZ-së**

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

- -Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës të Votave me Kusht për Zgjedhjet Lokale 2021
- -Shqyrtimi dhe miratimi i Trendëve Zgjedhore 2009-2021
- Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për Edukim dhe Informimin e Votuesve në vitet Jo Zgjedhore
- -Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës së Rinumërimit të Vendvotimeve 2009-2021
- -Shqyrtimi dhe miratimit i listës së rreziqeve dhe plani i vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut në KQZ.
- Njoftim për zbatimin e Planit të Punës së KQZ-së për vitin 2022 (vlerësimi preliminar).

- **Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

- Njoftim lidhur me raportin e komisionit për dhurimi të Tabletave PC-Prestigio – OJQ-ve dhe Institucioneve.

- **Këshilli për Çështje Ligjore**

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Gjilan

6. Të ndryshme

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Krvesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: Falemnderit, po e hapi mbledhjen e 44-t. Rendin e ditës e keni përpara, a ka kush dicka lidhur me rendin e ditës...?

Arianit Elshani, këroi të tërhiqet pika “Shqyrtimi dhe miratimit i listës së rreziqeve dhe plani i vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut në KQZ”, meqë sic tha, edhe ashtu konsideroj që ende nuk është e shqyrtuar deri në fund nga KOZ. Edhe një pikë tjetër, z. Elshani e propozoi që të hiqet nga rendi i ditës (Strategjia për Edukim dhe Informimin e Votuesve në vitet jo zgjedhore)...!

Kreshnik Radoniqi: I heqim këto dy pika, dhe të shohim se ku po mbërrijmë...A ka dikush tjetër...? Nëse nuk ka, atëherë vazhdojmë me pikën tjetër...?

Në vazhdim, u miratuan procesverbalet numë nr. 38, 39 dhe 40/2022 (me kërkesë për plotësim të pjesës ku diskutohet për “PZAP” në procesverbalet nr. 38, me vërtjetet e z. Alim Rama.) Gjithashtu, z. Sami Kurteshi, kërkoi që procesmbajtësi të jetë prezent vazhdimisht në takimet e KQZ-së për shkak të lëshimeve të mundëshme në përmbajtjen e takimeve nga shkak i mos pjesëmarrjes – përgjatë shqyrtimit të piakave të rendit të diës etj.

Në fund, miratohen pika e rendit të ditës.

2. Aktivitetet e SKQZ-së

Burim Ahmetaj, tha se në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 66.5 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe Udhëzimin Administrativ të KQZ-së Nr.02/2022, për Menaxhimin e Pasurisë Jo financiare të KQZ-së, me datë 5 dhjetor 2022 është formuar komisioni për inventarizimin e pasurisë jo financiare të KQZ-së, duke i përfshirë edhe KKZ-të; Komisioni është formuar në kohën kur Sekretariati ka qenë në përgatitje të zgjedhjeve të cilat kanë qenë të planifikuara të mbahen me 18 dhjetor dhe sic thash, përfshinë inventarizimin e gjithë pasurisë jo financiare që, është në pronësi dhe në kontroll të KQZ-së, verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes së pasurisë, krahasimi i gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare, identifikimi i pasurisë që nuk ka vlerë të bartur (identifikimi i pasurive të dëmtuara dhe jashtë përdorimit), hartimi i raportit.

Raporti i inventarizimit, duhet të përmbajë gjendjen fizike të pasurisë jo financiare, kushtet e ruajtjes së tyre dhe vërejtjet mbi karakterin e diferencave, dhe dëmtimeve të konstatuara etj.

Në vazhdim të paraqitjes së aktiviteteve brenda dy takimeve, z. Ahmetaj tha se sekretariati i KQZ-së ka pasur të planifikuara për zgjedhjet e jashtëzakonshme që duhej të mbaheshin më 18 dhe 25 dhjetor 2022, rreth **566,450** euro. Sipas pasqyrave të shpenzimeve, janë bërë rreth 30 mijë euro shpenzime. Më konkretisht, janë shpenzuar prej **29,917** euro.

Ky raport, tha z. Ahmetaj, pasqyron edhe progresin e projektit “Informimi dhe Edukimi i Votuesve të Rinj për Zgjedhje” që ka filluar më 1 nëntori dhe i cili do të zgjasë deri më 30 dhjetor, 2022. Deri më 15 dhjetor 2022, në terren projekti është realizuar në komunat: Gjakovë, Drenas, Dragash, Istog, Klinë, Kamenicë,

Mitrovicë, Obiliq, Rahovec, Pejë, Prishtinë, Prizren, Skenderaj, Shtime, Shtërpçë, Suharekë, Ferizaj, Viti, Vushtrri, Malishevë, Junik dhe Hani i Elezit. Ndërsa në komunat: Gjilan, Kaçanik, Fushë Kosovë, Lipjan, Novobërdë, Podujevë, dhe Mamushë, projekti është në realizim e sipër.

Pjesëmarrja dhe interesimi i nxënësve të shkollave, sipas raportimeve ka qenë relativisht i lartë. Mirëpo, nga komunat: Graçanicë, Ranillug, Partesh dhe Killokot, kemi raportime se ende janë në fazën e koordinimit me DKA-të dhe Drejtorët e shkollave nëse, mund të realizohet ky projekt. Kurse, sic mund ta merrni me mend, nga ZLKZ-të e katër komunave veriore nuk kemi pranuar ndonjë raportim, si shkak i situatës së krijuar së fundmi.

Sami Kurteshi, tha se e ka lexuar raportin, ndërsa zyrtari i Graçanicës “paska dërguar një arsyetim se”, kryetari i kësaj komune nuk paska lejuar aktivitetin...! Për këtë nuk vendos kryetari i komunës, tha z. Kurteshi. Më duket, është një lojë: bojkotimi i zgjedhjeve...

Duhet një letër, një dëshmi, një dokument dhe jo kështu....! Por ai s’guxon, kryetari i komunës sepse janë ligjet, mirëpo kjo është lojë, ndërhyrje e Listes Serbe që është një organizatë terrorise...! Kërkoj që në mbledhjen e ardhshme ta kemi raportin me dëshmi...

Në këtë pikë, foli edhe Arianit Elshani, i cili mbështeti propozimin që të ketë dokument se pse nuk mbahet një aktivitet i këtillë...

3. Raport nga Zyra e ZRCKFSP-së

Rekomandim për çregjistrimin e Partisë Politike Ujedinjena Stranka Bošnjaka-USB:

Vesa Xharra, përfaqësuese e zyrës së RCKFSP-së tha se zyra ka sjellë rekomandimin për çregjistrimin e partisë politike “Ujedinjena Stranka Bošnjaka”-USB sepse, kjo parti nuk ka arritur ta mbajë kuvendin ashtu sic, është me ligj. Edhe përkundër shtyrjes, pezullimit nga KQZ dhe atitit shtesë për mbajtje të kuvendit, ky subjekt nuk e ka mbajtur kuvendin. Ne kemi kontaktue këtë subjekt, dhe ata nuk na kanë dhënë arsye se pse nuk kanë mbajtur kuvendin. Zyra, propozon çregjistrimin...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për këtë rekomandim...?

Anëtarët e KQZ-së me 10 vota për, miratuan çregjistrimin e këtij subjekti politik.

4. Raportet e Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Buxhet dhe Financa:

Njoftim lidhur me raportin e komisionit për dhurimi të Tabletave PC-Prestigio – OJQ-ve dhe Institucioneve:

Gordana Llaban: Të nderuar kolegë, në takimin e mbajtur zëvendkryeshefi ka informuar lidhur me donacionin e tabletave. E keni raportin. Ne, kemi diskutuar dhe kemi përkrahur se ky është një gjest i mirë... Nuk kërkohet votim nga KQZ, kjo është vetëm informatë.

5. Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Gjilan:

Sami Hamiti, tha se në mbledhje të këshillit kemi trajtue kërkesën e kryesuesit të kuvendit komunal të Gjilanit dhe të kryesuesit të kuventit të Zubinpotokut. Prandaj, tha z. Hamiti, sot kemi dy zëvendësime.

Me 10 vota për, miratohet ky zëvendësim

Në Gjilan, asambleisti Arianit Ibrahimit nga AKR ka dhënë dorëheqje të parevokueshme për shkaqe personale. Të njëjtin, e zëvendëson Sebahate Hajdini nga AKR. Kurse, Ivana Milivojeviq nga Serbska Lista zëvendësohet nga kandidati i radhës së lëvizjes Vetvendosje që ka më shumë vota, Bilall Uka

Me 10 vota për, miratohet ky zëvendësim

6. Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës të Votave me Kusht për Zgjedhjet Lokale 2021:

Arianit Elshani, tha se këshilli ka shqyrtuar analizën e votave me kusht për zgjedhjet lokale të vitit 2021 të cilën analizë, e ka përgatitur DOZ. Më 17 tetor, 2021 kanë votuar me kushtë 13 194 votues prej të cilëve 12 375 votues janë konfirmuar nga QNR, ndërsa janë refuzuar 819 votues.

I keni në formë tabelare për secilen komunë, tha z. Elshani i cili pastaj, paraqiti edhe të gjeturat nga kjo analizë me shifra konkrete, krahasimet, efektet etj.

Në këtë pikë, diskutuan gjatë: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Rifat Krasniq, Alim Rama, Arianit Elshani dhe Burim Ahmetaj.

Në fund, votimi i kësaj pike u pasua nga 4 rekomandime të raportit, si dhe u propozuan edhe një rekomandim tjetër: Marja e masave ndaj personave që kanë bërë gabime. Ndërsa, propozimi i z. Sami Kurteshi që ti rekomandohet ARC-së (Departamentit për prodhimin e dokumenteve personale pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme), që dokumentet e personave që kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës, të anulohen dhe të shpallen si dokumente të pavlefshëm, të diskutohet në takimet me zyrtarët e MPB-së.

Në fund, me 10 vota për dhe me një abstenim (Sami Kurteshi), u miratua analiza e votave me kusht për Zgjedhjet Lokale 2021, me bashkangjtitjen edhe të një rekomandimi tjetër...

2.Shqyrtimi dhe miratimi i Trendëve Zgjedhore 2009-2021:

Arianit Elshani, tha se këshilli e ka shqyrtuar edhe trendeve zgjedhore duke u mbështetë në të dhënat zgjedhore. Në paraqitjen tabelare, janë të paraqitura proceset zgjedhore që prej vitit 2009. Ai ndër të tjera, tha se, dalja më e madhe në zgjedhje për kuvend prej 47.68 % (zgjedhjet 2021), pastaj pjesëmarrja më e lartë e daljes në zgjedhje në vitin 2013 për zgjedhjet lokale 46.72%.

Po ashtu, nga të gjitha proceset zgjedhore meshkujt përbëjnë përgjigjen më të lartë në proces, ndërsa femrat me të drejtë vote, vetëm në zgjedhjet e vitit 2013 kanë pasur daljen më të lartë në votim...

Lidhur me këtë pikë, diskutuan: Sami Hamiti, që e vlerësoi si një dokuent shumë të mirë, pastaj Ilir Gashi i cili tha se po, ky është një prej raporteve më të nevojshme, sidomos për palët e treta...Diskutuan pastaj, edhe Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Alim Rama dhe Valmir Elezi.

Me 11 vota për, u miratuan trendet zgjedhore: 2009-2021

4.Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës së Rinumërimit të Vendvotimeve 2009-2021:

Arianit Elshani, tha se e këshilli ka shqyrtuar edhe analizën e rinumërimit të vendvotimeve nga proceset zgjedhore: 2009-2021. Ai pastaj, pasqyroi edhe elementet substanciale të kësaj analize, çështjet që kanë ndikuar në rinumrim, efektet, problemet etj.

Në këtë pikë, diskutuan edhe: Sami Kurteshi, Alim Rama, Sami Hamiti, Burim Ahmetaj, dhe Čemailj Kurtiš.

Me 11 vota për, miratohet analiza e rinumërimit të vendvotimeve 2009-2021.

6. Njoftim për zbatimin e Planit të Punës së KOZ-së për vitin 2022 (vlerësimi preliminar):

Arianit Elshani, ky është një njoftim, sepse KOZ –i ka marrë një raport nga Sekretariati për zbatimin e planit të punës së KOZ-së për vitin 2022. Ndonëse plani nuk është i përditësuar sipas kërkesave tona nga KOZ që ti vendosim standardet: pra të listohen aktivitetet e realizuara, ato gjysmë të realizuara dhe të tjerat, të përealizuara.

z. Elshani, në vazhdim, e informoi KQZ më në detaje rreth realizimit të aktiviteteve, përgjegjësit e aktiviteteve etj.

Në këtë pikë, diskutoi: Sami Kurteshi.

Të ndrrshme !

Kreshnik Radoniqi, e informoi KQZ-nw se wshtw kontaktuar Komisionin e Kuvendit, dhe se nuk ka mundësi të shtyhet, prandaj Sami Kurteshi, Alim Rama dhe Arianit Elshani marri pjesë..